

Në Kosovë numri i homoseksualëve, dita-ditës në rritje

Homoseksualët duan të drejta në Kosovë

Ato bashkëtojnë tash sa kohë dhe nuk ngurrojnë ta ledhatojnë njëra-tjetrën në publik. Ankohen se nuk ka një ligj që do t'ua mundësonte lidhjen e kurorës

PRISHTINE, 26 GUSHT - Dy vajzat ishin ulur në njërin nga restorantet e Prishtinës dhe me fytyra të qeshura e me veshje që nuk daltonë nga vajzat e tjera të Kosovës, ia ledhatonin duart njëra-tjetrës, duke rrëfyer për dashurinë e madhe që kanë mes vete. Aq shumë e duan njëra-tjetrën, sa që edhe ushqimin e porosisin në të njëjtën pjatë.

Dy vajzat, homoseksuale, ka disa javë që jetojnë së bashku në një apartament. Mirëpo, ato duan të drejta për homoseksualët, përfshirë të drejtën për të pasur një certifikatë martesë. Janë të bindura se një dokument të tillë do ta posedojnë së shpejti.

Ato një gjë të tillë nuk mund ta kenë në Kosovë për shkak se i takojnë të njëjtës gini, që të dyja janë femra me moshë jo të njëjtë dhe një ligj për një gjë të tillë në Kosovë nuk ka. "Dëshira ime është që këtë dokument ta kemi nga Kosova, edhe pse duhet ende kohë, mirëpo shpresoj që së shpejti do të bëhet një gjë e tillë edhe në vendin tonë", shprehet B. M., njëra nga dy të dashuruarat.

Me marrjen e një certifikate të tillë, ajo shprehet se së shpejti mendojnë të kenë edhe familje.

"Krijimin e familjes e kuptojmë si dy veta për këtë moment, e në të ardhmen besojmë që do t'i kemi do të drejta më shumë edhe besoj që do të kemi familje, pasi që ne, përveç se po jetojmë bashkë, mbi të gjitha e duam njëra-tjetrën", bën të ditur B.M. Ajo thotë se jeta e tyre e përditshme

është dallon nga jeta e të rinjve të

"Dallim te ne është vetëm orientimi seksual", shprehet ajo.

Vajza me inicialet B.M. pohon se ndryshe nga të rinjtë e tjerë, homoseksualët në Kosovë shpeshherë hasin në diskriminim si dhe në moslejtim të gjërave të ndryshme për shkak të barrierave që janë të krijuara për këta njerëz.

B.M. nuk dëshiron të tregojë për ndjenjat e saj të para ndaj vajzave. "Nëse tregoj pam sa lobe e kom vërejt vetën që unë i takoj një komuniteti tjetër më bjen të të tregoj edhe sa vjet i kam", thotë ajo. Sipas saj, jo vetëm tek ajo, por te të gjithë njerëzit adoleshencë është ajo e cila përcakton preferencat seksuale të njerëzve.

"Ka qenë vetëm adoleshencë kur preferencat e mia kanë dalë në pah", thotë B.M.

Organizatë që rritet

Ajo është edhe njëra nga tre themelueset e Qendrës për Emancipim Shoqëror (QESH), e cila është krijuar në prill të vitit të kaluar në Kosovë, me financim të Ministrisë së Jashtme të Holandës. Fillimisht kjo organizatë kishte rreth njëzet anëtarë mirëpo B.M. bën të ditur se me kalimin e kohës pjesëtarët e kësaj organizate janë shtuar vazhdimisht kështu që numri i tyre tashmë arrin afro njëqind. Kjo organizatë sipas B.M. është e hapur për të gjithë njerëzit: lezbikët, getë, biseksualët, si dhe për ata që janë të shoqëruar me homoseksualët dhe që nuk u pengon një gjë e tillë. "Kemi shumë shokë dhe shoqe që janë të



Pamje nga një paradë e homoseksualëve në Perëndim

shoqëruar me ne dhe neve. Kjo na bën të ndihemi shumë mirë pasi që numri i tyre vazhdimisht është në rritje, pasi që është shumë mirë kur e lufton një padrejtësi bashkë me njerëzit e tjerë", thotë ajo.

Në këtë organizatë sipas B.M. numri i femrave është shumë më i vogël sesa i meshkujve, kjo, sipas saj, pasi që femrat nuk kanë qenë të organizuara më herët.

"Kjo është pak a shumë e kuptueshme pasi që diskriminimi është i dyanshëm për femra, një pse je femër dhe tjetra pse je lezbike", citon ajo.

Ajo thotë se njerëzit e tillë nuk mund t'i dallosh në pamje fizike se i takojnë një pjesë tjetër të shoqërisë, mirëpo B.M. tregon se shumë herë dëgjojnë fjalë kërcënuese dhe ofenduese ndaj tyre, prandaj kjo është edhe arsyeja që homoseksualët nuk shfaqen shumë nëpër rrugët e Kosovës. Ajo thotë se aktivitetet që zhvillohen në këtë organizatë janë të shumta.

"Përpiqemi t'u përshtrahemi ligjeve, bisedojmë për rregulloren kundër diskriminimit, mendohejmë të bëjmë vetëdijësimin e njerëzve për të drejtat tona, etj.", thotë B.M.

Edhe pse kjo organizatë aktualisht ka donacione nga jashtë, themeluesit e saj shpresojnë që së shpejti do të hasin në mirëkuptim tek ministrët tona edhe me gjithë faktin se, sipas B.M., deri tani dyert institucioneve vendore për këta njerëz kanë qenë të mbyllura. "Duhet të bëhet edhe në Kosovë shumë shpejt për shkak se kjo është duke u bërë edhe njëra nga standardet e Kombeve të Bashkuara dhe Evropës", pohon ajo.

Kjo organizatë, sipas B.M., do të punojë edhe në të ardhmen në mënyrë që pjesëtarët e saj dhe të

tjerët njerëz të ngjashëm si ky komunitet që do të dalin në pah "të mos e ndiejmë vetën të diskriminuar, të dalim në rrugë pa frikë", thotë ajo.

Nuk është sëmundje

Luigj Ndou, psikiatër, thotë se një fenomen i tillë tashmë nuk mund të logaritet si sëmundje apo si çrregullim, mirëpo si zgjedhje e njerëzve për orientimin e tyre seksual. "Edhe pse në të kaluarën ka pasur tendencë të tilla dhe janë injoruar nga shoqëria, mendoj se me kalimin e kohës ky fenomen nuk paraqet problem psikologjik", ka thënë ai. Sipas tij, në të kaluarën raste të shumta të homoseksualëve ka pasur në shërbimin ushtarak si dhe në burgje.

Mirëpo një gjë të tillë nuk e pohon edhe Ferid Agani, psikiatër. Edhe pse Agani një dukuri të tillë nuk e konsideron si sëmundje, edhe pse një gjë e tillë, sipas tij, ishte menduar deri në vitet 80, mirëpo ai thotë se kjo është "paraqet një loj çrregullimi, për të cilin shkencëtarë tani nuk ka arritur të japë definim të plotë".

"Sipas përvojës sime, homoseksualizmi më shumë është një çrregullim, që nuk është as në dobi të individit e as në dobi të shoqërisë", ka pohuar ai.

Megjithatë nga aspekti psikologjik, homoseksualizmi nuk logaritet si sëmundje apo çrregullim tek individit të caktuar, Dom Albert Demaj, përfaqësues nga Kisha Katolike bën thirrje tek institucionet kosovare përgjegjëse që sa më shpejt të merren masa që të bëjnë shërimin dhe vetëdijësimin e njerëzve të tillë. "Kisha në asnjë mënyrë nuk e përkrah homoseksualizmin,

përkundrazit e shëh si sjellje perverse të individëve të caktuar", ka bërë të ditur Demaj.

Ndërsa në mesin e shumë kishillave që gjenden në librin e shërbët mysliman Kur'an, janë edhe ato që pikërisht ndalojnë rreptësisht fenomene dhe dukuri të tilla. Sipas këtij libri "A shkoni pas meshkujve të kësaj bote? E gratë tuaja i lini anash, të cilat Zotit i krijoj për ju" islami ndalon rrugët që të shpijnë drejt imoralitetit duke i konsideruar ato si të ndaluara pasi janë shkak për rënien në to.

Sipas këtij libri, Allahu e ka mallkuar gruan që vishet si burrat dhe burrat që vishen si gratë si dhe të gjitha paraqitjet e tjera me të cilat femra i ngjan mashkullit dhe mashkulli i ngjan femrës.

Qytetarët kanë mendime të ndryshme

Derisa për një pjesë të njerëzve shoqërimi me homoseksualët nuk është pengesë absolute, për një pjesë të madhe të tyre ata konsiderohen krejtësisht ndryshe.

"Ata janë njerëz të çmendur, të pasqurullor dhe njerëz pa ndjenja", pohon Agron Batalli, një i ri rreth të njëzetave.

Aj thotë se nuk ka shokë apo shoqe të tilla mirëpo siç pohon ai njerëzit e tillë as që do të mund t'i pranonte në shoqërinë e tij. Agroni jo shumë shpesh has në njerëz të tillë, mirëpo thotë se nuk i përkrah dhe nuk i arsyeton në asnjë mënyrë ndjenjat e tyre për gjininë e njëjtë. Edhe Pranvera Hoxha, një e re nga kryeqyteti, edhe pse në një farë mënyre mundohet t'i kuptojë homoseksualët, mirëpo, siç thotë ajo, "nuk ia arrij dot".

"Nuk e di se çfarë ndjenjash mund të kenë këta njerëz ndaj njerëzve të gjinisë së njëjtë, nuk mund t'i kuptoj aspak". Ajo thotë se në punën e saj ka kolegë të tillë, mirëpo me ta, siç ka thënë Pranvera për gazetën, bisedon vetëm për çështje profesionale "posa të hapet një temë e tillë unë largohem nga ta se e di që menjëherë bie në konflikt", shprehet ajo.

Selvia Bajrami